



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

V E N D I M

Nr. 199/1, datë 12.05.2021

PËR

**MBYLLJEN E PROCEDIMIT DISIPLINOR PA ZHVILLUAR SEANCË  
DËGJIMORE PËR ISH MAGJISTRATIN {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 147 pika 1, 147/a pika 1, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 139 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 31, pika 1, shkronja “a” të Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, nenin 97, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3, të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sot me datë 12.05.2021, mori në shqyrtim, në mbledhje plenare, kërkesën për procedim disiplinor nr.02/2021, që i përket:

**KËRKUES:** Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z.Artur Metani.

**SUBJEKT I PROCEDIMIT:** Z. {...}, ish magjistrat i Gjykatës së Apelit {...}.

**OBJEKTI I KËRKESËS:**

1. Fillimin e procedimit disiplinor ndaj ish magjistratit z. {...}.
2. Propozimin për caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”.

**BAZA LIGJORE:** Neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Nenet 104, pika 3 dhe 111 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në përputhje me parashikimet e nenit 139 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e

Shqipërisë”, i ndryshuar, dëgjoji relatorin e çështjes, z.Medi Bici, si dhe shqyrtoi propozimet e Komisionit Disiplinor, në përfundim;

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (referuar në vijim dhe si Këshilli), në datë 26.04.2021, me nr.1796 prot., është depozituar kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj z.{...}, z. {...}dhe z. {...}, me detyrë gjyqtarë të Gjykatës së Apelit {...}, në kohën e kryerjes së shkeljeve disiplinore objekt procedimi<sup>1</sup>.

2. Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor mbështetet në nenin 194 të ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe nenin 138 të ligjit nr.96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, (referuar në vendim si ligji “Për Statusin”), për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 104, pika 3 e ligjit “Për Statusin”.

2.1 Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë (referuar në vijim dhe si ILD) ka paraqitur propozimin për caktimin ndaj secilit prej tyre, të masës disiplinore “*Shkarkim nga detyra*”, të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja ”b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 104, pika 3 dhe 111 të ligjit “Për Statusin”.

3. Nga dosja hetimore e depozituar pranë Këshillit, rezulton se Prokuroria {...} ka regjistruar procedimin penal nr.113/2015, për veprat penale “*Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë*” dhe “*Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*”, të parashikuara nga nenet 319 dhe 319/ç e 25 të Kodit Penal. Në këtë procedim penale kanë marrë cilësinë e personave nën hetim shtetasit {...}, {...}dhe {...}, të cilët, në atë kohë, ushtronin detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit {...}.

4. Gjatë hetimeve paraprake të organit të Prokurorisë ka rezultuar se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...} ishte zhvilluar një proces gjyqësor civil midis palëve paditëse {...}, {...}, {...} dhe i paditur {...}, person i tretë {...} me objekt të padisë, pushim cënimi në pronësi. Me vendimin nr.1302, datë 14.05.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor {...} ka vendosur pranimin e pjesëshëm i padisë. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim nga i padituri {...} në Gjykatën e Apelit {...}. Me vendimin nr.10-2015-387 (160), datë 18.02.2015, Gjykata e Apelit {...} ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.1302, datë 14.05.2013 të Gjykatës së

---

<sup>1</sup>Shkresa Nr.1594/8prot., datë 26.04.2021 e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Rrethit Gjyqësor {...} dhe rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj. Kjo çështje, në këtë gjykatë, është gjykuar nga trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}.

5. Pas dhënies së këtij vendimi shtetasi {...} ka paraqitur kallëzim penal, duke pretenduar se vendimi i Gjykatës së Apelit {...} është rrjedhojë e ndikimit të shtetasit {...}, si dhe përfitimeve të parregullta që kanë marrë prej tij gjyqtarët e çështjes, për të cilët pretendonte se kanë udhëtuar jashtë shtetit së bashku me palën në proces gjyqësor. Nga ana e Prokurorisë janë kryer veprimet hetimore përkatëse, mbi bazën e të cilave, është vlerësuar se krijoheshin dyshime se, gjyqtarët e çështjes {...}, {...} dhe {...}, në kohën që gjykimi i kësaj çështje gjyqësore ka qenë në zhvillim e sipër, kanë përfituar nga shtetasi {...} përfitime të parregullta, me qëllim dhënien e vendimit gjyqësor në favor të këtij të fundit.

6. Gjykata {...}, me vendimin nr. 436, datë 12.12.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë datë 11.12.2017, me objekt caktim mase sigurimi ndaj magjistratëve {...}, {...} dhe {...} si dhe ndaj shtetasit {...}. Në këtë vendim, në paragrafin 68 të tij, arsyetohet se: *“Në vlerësim të kësaj gjykate, fakti që shtetasit {...}, {...} dhe {...}, me cilësinë e gjyqtarit të çështjes, kanë patur komunikime telefonike me shtetasin {...}, i cili ka qenë palë në çështjen që po gjykohej prej tyre, si dhe fakti që ekzistojnë dyshime të arsyeshme se shtetasit {...} dhe {...} mund të kenë udhëtuar me shtetasin {...} për në Romë Itali, në datat 02 dhe 05 dhjetor 2014 dhe në Spanjë, në datat 24 dhe 26 .10.2014 si dhe gjyqtari {...} , mund të ketë udhëtuar në Spanjë me shtetasin {...} në datat 24 dhe 26.10.2014, nuk krijojnë dyshime të arsyeshme që, ato, si gjyqtarë të kenë marrë përfitime dhe favore të parregullta nga shtetasi {...}, duke iu paguar ky i fundit biletat e udhëtimit dhe faturat e qëndrimit në hotel, por, është një provë që tregon se gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}, mund të ketë shkelur Kodin Etik të Gjyqtarëve, konkretisht nenet 1,3 dhe 15 të tij, të cilat parashikojnë se, gjyqtari duhet të sillet me dinjitet dhe paanësi, si gjatë veprimtarisë gjyqësore ashtu edhe jashtë kohës së punës, si dhe duhet të shmang takimet ose kontaktet “exparte” apo jashtëgjyqësore me njërën ose të gjitha palët e gjykimit që ai gjykon, ashtu siç ka dyshime të arsyeshme se ka ndodhur në rastin konkret”.*

7. Me Urdhrin nr. 3809/1prot, datë 09.01.2018 të Kryeinspektores së Inspektoratit të KLD-së, është çmuar me vend verifikimi i informacionit, të përcjellë nga Prokuroria {...}, me marrjen e të dhënave shtesë, dhe në vijim me vendimin nr. 3809/10 prot., datë 17.01.2018, është vendosur fillimi i hetimit disiplinor ndaj gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}, për shkelje të rëndë të etikës gjyqësore, parashikuar nga neni 140/2, shkronja a) e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

8. Në vijim, Prokuroria {...} ka përcjellë vendimet për marrjen të pandehur dhe njoftimin e akuzës për gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}, për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 319/ç e 25 të Kodit Penal<sup>2</sup>.

<sup>2</sup>Shkresa nr. 1150 prot, datë 05.02.2018, regjistruar në IKLD-së me nr.3809/19 prot datë 06.02.2018.

9. Me vendimet nr. 22, 23 dhe 24, datë 09.02.2018, ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vendosur pezullimin përkohësisht nga ushtrimi i detyrës i gjyqtarëve {...}, {...}dhe {...}, për shkak të marrjes së tyre, si të pandehur nga Prokuroria {...}. Kundër këtyre vendimeve nuk është ushtruar ankim.

10. Referuar objektit të hetimit disiplinor, të filluar ndaj tre gjyqtarëve për shkelje të etikës gjyqësore, me vendimin nr. 3809/28 prot., datë 20.03.2018 të Kryeinspektores është vendosur pezullimi i hetimit disiplinor deri në dhënien e vendimit të formës së prerë nga organi procedues për akuzën penale të ngritur.

11. Praktika e mësipërme në gjendje të pezulluar, i është përcjellë nga Këshilli, Zyrës së ILD-së, me krijimin e saj. Gjatë shqyrtimit të praktikave nga ana e ILD-së, është konstatuar se me vendimin gjyqësor nr. 69, datë 29.10.2019 të Gjykatës {...} është vendosur:

“1.1 Deklarimi fajtor i të pandehurit {...} për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 319/ç dhe 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij në bazë të kësaj dispozite me 3 vjet burgim. 1.2. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e dënimit me 1/3 dhe dënimin përfundimtar të të pandehurit {...} me 2 vjet burgim. 1.3. Në mbështetje të nenit 30/1, 35/1 dhe 44/2 të Kodit Penal, heqjen e të drejtës për të pandehurin {...} për të ushtruar funksione publike, për 5 vjet, zbatimi i të cilës fillon pas vuajtjes së dënimit me burgim.

2.1. Deklarimi fajtor i të pandehurit {...} për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 319/ç dhe 25 të K.Penal dhe dënimin e tij në bazë të kësaj dispozite me 3 vjet burgim. 2.2. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e dënimit me 1/3 dhe dënimin përfundimtar të të pandehurit {...} me 2 vjet burgim. 2.3. Në mbështetje të nenit 30/1, 35/1 dhe 44/2 të Kodit Penal, heqjen e të drejtës për të pandehurin {...} për të ushtruar funksione publike, për 5 vjet, zbatimi i të cilës fillon pas vuajtjes së dënimit.

3.1. Deklarimi fajtor i të pandehurit {...} për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 319/ç dhe 25 të K.Penal dhe dënimin e tij në bazë të kësaj dispozite me 3 vjet burgim. 3.2. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e dënimit me 1/3 dhe dënimin përfundimtar të të pandehurit {...} me 2 vjet burgim. 3.3. Në mbështetje të nenit 30/1, 35/1 dhe 44/2 të Kodit Penal, heqjen e të drejtës për të pandehurin {...} për të ushtruar funksione publike, për 5 vjet, zbatimi i të cilës fillon pas vuajtjes së dënimit me burgim.

4.1. Deklarimin fajtor të të pandehurit {...}. për kryerjen e veprës penale *“Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit, dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”* të parashikuar nga neni 319 i Kodit Penal dhe dënimin e tij në bazë të kësaj dispozite me 1 vit dhe 6 muaj burgim.4.2. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e dënimit me 1/3 dhe dënimin përfundimtar të të pandehurit {...}. me 1 burgim....”

12. Mbi bazë ankimi, Gjykata {...}, me vendimin nr. 19, datë 21.09.2020, ka vendosur:

“1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 69 datë 29.10.2019 të Gjykatës {...}. 2. Ndrejten e vendimit nr. 69, datë 29.10.2019, mbi gabimin material në pikën 4.2 të dispozitivit duke u shtuar fjala “vit” pas numrit 1, duke u urdhëruar shënimi në origjinalin e aktit. 3. Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim nr. 69, datë 29.10.2019, të Gjykatës {...} për të pandehurin {...}, duke vendosur në afat prove prej 4 vjetësh, me kusht që të mos kryejë vepër tjetër penale, duke mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës. 4. Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim nr. 69, datë 29.10.2019, të Gjykatës {...} për të pandehurin {...}, duke vendosur në afat prove prej 4 vjetësh, me kusht që të mos kryejë vepër tjetër penale, duke mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës. 5. Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim nr. 69, datë 29.10.2019, të Gjykatës {...} për të pandehurin {...}, duke vendosur në afat prove prej 4 vjetësh, me kusht që të mos kryej vepër tjetër penale, duke mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës. 6. Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim nr. 69, datë 29.10.2019, të Gjykatës {...} për të pandehurin {...}. duke vendosur në afat prove prej 2 vjetësh, me kusht që të mos kryejë vepër tjetër penale, duke mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës. Lënien në fuqi të vendimit nr. 69 datë 29.10.2019 për pjesët e tjera të tij... .”

13. Më datë 03.11.2020 Prokuroria {...}, ka nxjerrë urdhrat respektivë për ekzekutimin e vendimit penal nr. 69, datë 29.10.2019 të Gjykatës {...}, të ndryshuar me vendimin nr. 19, datë 21.09.2020 të Gjykatës {...}, duke urdhëruar Këshillin për ekzekutimin e dënimit plotësues të caktuar në vendim.

14. Në kushtet kur konstatoi se kishte rënë shkak i pezullimit, me vendimin nr. 2591/5, datë 24.02.2021, ILD-ja ka vendosur vazhdimin e hetimit disiplinor të pezulluar dhe për sa u parashtrua, me vendimin nr.2591/5, datë 24.02.2021, ka vendosur ndryshimin e objektit të hetimit disiplinor nga shkelje të rënda të etikës gjyqësore, të parashikuar nga neni 140 pika 2 shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkeljen disiplinore për shkak të kryerjes së një krimi për të cilin secili subjekt i proceduar është dënuar me vendim të formës së prerë, të parashikuar në nenin 140 pika 2 shkronja “b” të Kushtetutës dhe nenin 104, pika 3 e ligjit “Për Statusin”.

15. Gjatë hetimit disiplinor është kërkuar informacion pranë Këshillit, mbi statusin aktual të secilit subjekt të hetimit disiplinor. Sipas informacionit, të vendosur në dispozicion, ka

rezultuar se subjekti {...}, është shkarkuar nga detyra me vendimin nr. 111, datë 27.02.2019 të {...}, i lënë në fuqi nga {...}, me vendimin nr.14, datë 09.07.2020.

16. Sipas ILD-s, pavarësisht faktit se ndaj ish magjistratit {...} është marrë masa disiplinore e “Shkarkimit nga detyra”, bazuar në ligjin nr.84/2016, në kuptim dhe zbatim të nenit 134, pika 1, shkronja “ç” të ligjit “Për Statusin”, ky nuk është shkak për mbylljen e hetimit disiplinor, pasi shkarkimi nga detyra sipas ligjit nr.84/2016, nuk është një masë disiplinore e dhënë për përgjegjësi disiplinore sipas parashikimeve të ligjit “Për Statusin”.

## II. PRETENDIMET E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

17. Me vendimin e datës 05.02.2018 Prokuroria {...} ka njoftuar akuzën dhe ka marrë si të pandehur gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}, gjyqtarë pranë Gjykatës së Apelit {...}, për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 319/ç e 25 të Kodit Penal. Me vendimet respektive nr.22, nr.23, dhe nr.24, datë 09.02.2018, ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vendosur pezullimin përkohësisht të tyre nga ushtrimi i detyrës.

18. Me vendimin nr.69, datë 29.10.2019, të Gjykatës {...}, ndër të tjera<sup>3</sup>, është vendosur deklarimi fajtor i magjistratëve {...}, {...} dhe {...}, për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 319/ç dhe 25 të Kodit Penal dhe dënimi i tyre, me 3 vjet burgim dhe në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, me 2 vjet burgim si dhe heqjen e të drejtës së tyre për të ushtruar funksione publike, për 5 vjet.

19. Gjykata {...}, me vendimin nr.19, datë 21.09.2020, ndër të tjera, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 69 datë 29.10.2019 të Gjykatës {...} dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim për magjistratët {...}, {...} dhe {...}, duke i vendosur ata në afat prove prej 4 vjetësh, me kusht që të mos kryejnë vepër tjetër penale, duke mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës.

20. Sipas informacionit të marrë nga ILD-ja, rezulton se kundër vendimit nr.19, datë 21.09.2020 të Gjykatës {...}, është ushtruar rekurs në Gjykatën {...}, ndërsa ende nuk ka një vendim përfundimtar nga Kolegji Penal i kësaj gjykate në kohën e hartimit të Raportit.

21. Nga përmbajtja e vendimit gjyqësor të formës së prerë<sup>4</sup> ka rezultuar se gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}, gjyqtarë të Gjykatës së Apelit {...}, kanë udhëtuar në të njëjtën datë dhe në të njëjtën orë, të gjithë së bashku, me destinacion Tiranë – Romë me linjën ajrore “Alitalia”, me

---

<sup>3</sup>Me anë të këtij vendimi është deklaruar fajtor dhe dënuar edhe shtetasi {...}, për veprën penale të parashikuar nga neni 319 i Kodit Penal.

<sup>4</sup>Shih vendimin nr. 69, datë 29.10.2019 e Gjykatës së {...}, dërguar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

numër fluturimi “{...}”, Romë. Gjithashtu, të gjithë këta shtetas, në datë 05.10.2014, në të njëjtën orë, janë kthyer së bashku me destinacion Bari-Tiranë me linjën ajrore “Alitalia”, me numër fluturimi “{...}”. Nga analizimi dhe i komunikimeve telefonike ka rezultuar se i pandehuri {...} ka pasur njohje personale me të tre gjyqtarët e çështjes gjyqësore, ku ka qenë palë ndërgjyqëse. Në kohën që çështja ka qenë në pritje për t’u gjykuar në Gjykatën e Apelit {...}, ky shtetas ka patur thirrje telefonike dhe mesazhe të përsëritura me secilin nga gjyqtarët e çështjes. E njëjta situatë është provuar dhe në episodin e dytë, udhëtimi në Spanjë, në datat 24.10.2014-26.10.2014. Ndaj në vlerësim të gjykatës, ka rezultuar se është provuar përtej çdo dyshimi fakti se gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë marrë/përfituar në mënyrë të parregullt vlerën e biletave të udhëtimit me destinacion Italinë (në datën 02-05.10.2014,) si dhe pagesën e akomodimit në Hotelin “{...}”, Spanjë për datat 24-26.10.2014, nga i pandehuri {...}, në këmbim të kryerjes së një veprimi që lidhet me detyrën, duke përmbushur kështu elementët e rëndësishëm të anës objektive të figurës së veprës penale të korrupsionit pasiv/aktiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë.

22. Gjykata {...}, në vijim të vendimit<sup>5</sup> të arsyetuar të saj, ka vlerësuar se në rastin konkret, nga ana objektive, u vërtetua se të pandehurit {...}, {...} dhe {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit {...} e kanë kryer veprën penale nëpërmjet përfitimit në mënyrë të drejtpërdrejtë nga i pandehuri {...} (palë ndërgjyqëse në kohën kur çështja ishte në gjykim e sipër nga të pandehurit më sipër), duke përmbushur kështu një nga format, figurën e plotë të anës objektive atë të marrjes së përfitimit të parregullt të veprës penale të korrupsionit të gjyqtarit në këmbim të kryerjes së një veprimi që lidhet me detyrën.

23. ILD-ja pretendon se, referuar fakteve dhe rrethanave të pranura nga gjykatat, veprimet e gjyqtarëve kanë cënuar veprimtarinë e rregullt të organeve të drejtësisë, nga veprimet e parregullta të personave të jashtëm, por edhe nga veprimet e vetë atyre si funksionar të drejtësisë. Këto veprime kanë cënuar besimin e palëve ndërgjyqëse dhe të publikut në organet e drejtësisë dhe respektimin e ligjit nga ana tyre, si dhe kanë diskretitur rëndë pozitën dhe figurën e magjistratit.

### **III. PROCEDURA E NDJEKUR NGA KOMISIONI I PËRHERSHËM DISIPLINOR**

24. Pas depozitimit të kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor, me vendimin nr.181, datë 29.04.2021, është vendosur hedhja e shortit dhe caktimi i anëtarit të Komisionit Disiplinor, z. Medi Bici, në cilësinë e relatorit të çështjes. Vendimi për caktimin me short të relatorit të çështjes i është njoftuar palëve të procedimit disiplinor përkatësisht ILD-së dhe ish magjistratit {...}, brenda afatit 5 ditor të parashikuar në nenin 141 të ligjit “Për Statusin”.

---

<sup>5</sup>Shih vendimin nr. 19, datë 21.09.2020 të Gjykatës {...}

25. Pas shqyrtimit të raportit të hetimit dhe akteve të dosjes hetimore, relatori i çështjes i ka propozuar Komisionit të Përhershëm Disiplinor të konsiderojë të plotë procedurën e verifikimit të kriterëve formale dhe kalimin për shqyrtim mbledhjes plenare të relacionit dhe projektvendimit përkatës. Në këtë relacion, relatori ka parashtruar propozimin e tij për mbylljen e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistratit {...}, pa zhvilluar seancë dëgjimore.

26. Në mbledhjen e datës 05.05.2021, duke e konsideruar të plotë procedurën e verifikimit të kriterëve formale, Komisioni i Përhershëm Disiplinor me shumicë votash ka vendosur kalimin për shqyrtim në mbledhje plenare të Këshillit, të propozimit për shqyrtimin në seancë dëgjimore të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj ish magjistratit {...}.

#### **IV. ARSYETIMI DHE VLERËSIMI I KËSHILLIT**

27. Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi u njoh me relacionin përkatës të çështjes si dhe raportin e dosjen hetimore, të paraqitur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, vlerësoi të ndalej në shqyrtimin paraprak të çështjeve që kanë të bëjnë me verifikimin e ekzistencës së shkaqeve ligjore që pasjellin vendimmarrjen e tij për mbylljen e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistratit {...}, pa zhvilluar apo caktuar seancë dëgjimore, shkaqe të parashikuara shprehimisht nga neni 139, pika 1 e ligjit “Për Statusin”. Këto shkaqe, për shkak të natyrës së tyre, ndalojnë fillimin e procedimit disiplinor dhe në rast se ai ka filluar, pengojnë vazhdimin e mëtejshëm të tij.

28. Me qëllim verifikimin e shkakut nëse shkeljet disiplinore janë parashkruar në kohën kur ka filluar hetimi nga ana e ILD, referuar nenit 139 pika 1, shkronja “a” e ligjit “Për Statusin”<sup>6</sup>, Këshilli konstaton se neni 117 i ligjit ka vendosur një afat të përgjithshëm pesë vjeçar parashkrimi. Në çdo rast afati i parashkrimit fillon nga momenti kur shkelja e pretenduar është kryer dhe pavarësisht këtij parashkrimi, për shkeljet disiplinore që përbëjnë njëkohësisht vepra penale, janë parashikuar afate parashkrimi të posaçëm, të cilët përlllogariten sipas parashkimeve të Kodit Penal, vetëm nëse në këtë Kod parashikohen afate parashkrimi më të gjata se pesë vjet.

---

<sup>6</sup>Neni 139 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar – “Mbyllja e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore - 1. Këshilli vendos mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore nëse: a) shkelja disiplinore është parashkruar në kohën kur ka filluar hetimi, sipas parashkimeve të nenit 117 të këtij ligji; b) çështja ka qenë objekt i procedimit disiplinor që është zgjidhur me vendim të formës së prerë; c) ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin, në përputhje me parashkrimet e nenit 134, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d”; ç) raporti i hetimit është depozituar pa u arsyetuar. 2. Dorëheqja e magjistratit nuk ndalon fillimin ose vazhdimin e procedimit disiplinor. 3. Këshilli mbyll procedimin disiplinor, sipas parashkimeve të pikës 1, të këtij neni, me vendim të arsyetuar me shkrim. Ai njofton palët për shkaqet e mbylljes.”



28.1 Në vijim të këtij përcaktimi ligjor, sipas të dhënave në dosjen hetimore dhe në raportin e hetimit, rezulton se me vendimin nr.3809/10 prot., datë 17.01.2018 të Kryeinspektorese së ish-Inspektoratit të ish KLD-së, është vendosur fillimi i hetimit disiplinor edhe ndaj z. {...}. Shkeljet disiplinore të pretenduara, të ndodhura në muajin Tetor të vitit 2014, përbëjnë njëkohësisht dhe veprën penale të “Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, sipas nenit 319/ç të Kodit Penal, nen i cili parashikon dënimin me burgim nga tre deri në dhjetë vjet. Duke patur në konsideratë datën e fillimit të hetimit disiplinor dhe afatin e parashkrimit për shkeljen disiplinore të pretenduar, i cili në rastin konkret është 10 vjet (referuar parashikimeve të nenit 66 të Kodit Penal), hetimi disiplinor është filluar brenda këtij afati parashkrimi.

29. Sipas parashikimeve të nenit 139 pika 1, shkronjat “b” dhe “ç” të ligjit “Për Statusin”, si shkaqe të tjera, të cilat sjellin si pasojë mbylljen e procedimit disiplinor, pa zhvilluar seancë dëgjimore, janë sanksionuar dhe rastet kur çështja objekt i procedimit disiplinor është zgjidhur me vendim të formës së prerë, si dhe kur raporti i hetimit është depozituar pa u arsyetuar.

29.1 Referuar të dhënave të dosjes hetimore, nuk rezulton që çështja apo shkeljet, objekt të kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj z. {...}, të kenë qenë objekt i ndonjë procedimi disiplinor, që është zgjidhur me vendim të formës së prerë. Po kështu, rezulton se në Këshillin e Lartë Gjyqësor është depozituar raporti i hetimit, i përgatitur nga Inspektore Marsela Pepi dhe miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 3 e Ligjit “Për Statusin”<sup>7</sup>. Raporti i hetimit është depozituar i arsyetuar në të gjithë elementët formalë të kërkuar nga kjo dispozitë ligjore.

30. Neni 139, pika 1, shkronja “c” e ligjit “Për Statusin”, përcakton arsye të tjera, të cilat sjellin si pasojë mbylljen e procedimit disiplinor, pa zhvilluar seancë dëgjimore, në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d” e këtij ligji. Sipas kësaj dispozite përcaktohet se Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin disiplinor, nëse provohet se rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se:

- *Së pari*, magjistrati i mbaron statusin, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat “b” deri në “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit<sup>8</sup> ose

---

<sup>7</sup>Neni 133 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar – “Dokumentacioni i hetimit - ... 3. Me përfundimin e hetimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë harton raportin e hetimit, i cili përmban të paktën: a) emrin dhe mbiemrin e inspektorit kompetent; b) shkaqet për të filluar hetimin, subjektin dhe objektin e hetimit, sipas përcaktimeve të bëra në vendimin për fillimin e hetimit, ndryshimin ose shtimin e objektit të hetimit; c) veprimet e kryera gjatë hetimit; ç) përmbledhjen e deklaratave të magjistratit përkatës dhe të personave të tjerë ose institucioneve; d) parashkrimin e fakteve të pranuar dhe të papranuara, ashtu si edhe të provave, si dhe vlerësimin e vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre; dh) analizën ligjore të fakteve të pranuar që mbështesin përfundimin se shkelja disiplinore e pretenduar është kryer ose se hetimi duhet mbyllur; e) propozimin për mbylljen e hetimit ose për fillimin e procedimit disiplinor dhe propozimin për caktimin e masës disiplinore.”

<sup>8</sup>Neni 64 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar – “Kohëzgjatja në detyrë e magjistratit - 1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: a) jep dorëheqjen; b) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; c) mbush moshën 67 vjeç; ç) shkarkohet nga

- *Së dyti*, nuk ushtron funksionin e tij në mënyrë të përhershme, sipas parashikimeve të nenit 67 të ligjit<sup>9</sup> ose
- *Së treti*, magjistrati ka vdekur.

30.1 Në vijim të plotësimit të plotë të kuadrit ligjor rregullues, neni 64 pika 1 e ligjit ka përcaktuar kohëzgjatjen në detyrë, duke parashikuar se statusi i magjistratit mbaron në rastet kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) vërtetohen kushtet e pa zgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;
- c) mbush moshën e pensionit;
- ç) *shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji;*
- d) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

30.2 Nga interpretimi i këtyre dispozitave, arrihet në përfundimin se rastet e mbylljes së procedimit disiplinor, pa seancë dëgjimore, janë përcaktuar në mënyrë shteruese në nenin 139 të ligjit, me anë të referencave ligjore vetëm në dispozitat e ligjit “Për Statusin”.

30.3 Nga të dhënat e dosjes hetimore rezulton se ish magjistrati {...}, ka qenë subjekt rivlerësimi në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016 “Për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe si i tillë i është nënshtruar rivlerësimit “ex officio” në {...}, proces ky i përfunduar. Konkretisht, me vendimin nr. 111, datë 27.02.2019, {...} ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit {...}, vendim i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. 14, datë 09.07.2020 të {...}.

30.4 Këshilli mori në shqyrtim këtë rrethanë faktike duke vlerësuar si vijon. Fillimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë ka si qëllim garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si edhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, me ndryshimet e vitit 2016, parashikoi ngritjen e sistemit të rivlerësimit, një proces ky i jashtëzakonshëm dhe tranzitor, që kryhet nga organet e pavarura kushtetuese dhe që ka për qëllim kontrollin e ligjshmërisë së pasurisë, të pastërtisë së figurës dhe të pasjes së aftësive minimale profesionale.

---

funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji; d) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën....”

<sup>9</sup>Neni 67 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar – “Pamundësia fizike dhe mendore e një magjistrati - 1. Me marrjen dijeni, Këshilli heton rastet për pamundësi fizike dhe mendore të magjistratit, të cilat çojnë në largimin nga funksioni ose pezullimin e përkohshëm të magjistratit... ”

30.5 Në kuadër të këtij procesi ligjor, Kushtetuta dhe ligji i dalë në zbatim të saj (Ligji nr. 84/2016), kanë konsideruar që, në raport me objektin e rivlerësimit kalimtar, {...} dhe {...} veprojnë si organe me natyrë disiplinore, si rrjedhojë vendimmarrjet e tyre, të dhëna brenda kompetencave të tyre, nuk mund të anashkaloen dhe të mos merren në konsideratë nga asnjë institucion, përfshirë edhe Këshillin e Lartë Gjyqësor. Në vendimin nr.02, datë 18.01.2017, Gjykata {...} është shprehur se: “22. *I gjithë procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si pjesë e paketës së reformës në drejtësi, edhe pse është një masë e jashtëzakonshme dhe me karakter të përkohshëm, është ngritur nga kushtetutë bërësi në rang kushtetues, duke parashikuar institucionet që do të kryejnë këtë proces, kompetencat e tyre, si edhe mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve dhe garancitë që ata gëzojnë. Qëllimi i përcaktimit të kompetencave të këtyre organeve në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kushtetutë do të thotë se asnjë institucion nuk mund të marrë këto kompetenca apo t'i anashkalojë ato*”.

30.6 Vendimi i {...}, lënë në fuqi nga {...}, për “*Shkarkimin nga detyra*” të z. {...}, përbën masë disiplinore në kuptim të legjislationit në fuqi, që përcaktohet shprehimisht në nenin 58, pika 1, sikundër edhe në nenin 61, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligj i cili rregullon procesin e rivlerësimit dhe masat disiplinore që mund të ndërmerren në kuadër të tij, përfshirë edhe ndaj gjyqtarëve subjekt rivlerësimi “*ex officio*”, sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

30.7. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka në konsideratë se vendimi i këtyre organeve kushtetuese për dhënien e masës disiplinore “*Shkarkim nga detyra*”, është një vendim, pasojat juridike e të cilëve fillojnë menjëherë, duke u përbërë shkak për ndërprerjen e menjëhershme të ushtrimit të detyrës nga gjyqtari ose prokurori subjekt rivlerësimi ndaj të cilit ai është marrë. Në pikën 7, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcaktohet se: “*Mos kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë.....*”.

30.8 Nga ana tjetër, një aspekt që mbahet në konsideratë nga ana e Këshillit, janë përcaktimet e nenit 164 të ligjit<sup>10</sup>, në të cilin parashikohen dispozita kalimtare për magjistratët e gjykatave dhe prokurorive të tjera. Sipas këtij neni gjyqtarët dhe prokurorët, në detyrë, gëzojnë statusin e magjistratit, vetëm nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore arrihet në përfundimin se ligji “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për aq kohë sa është duke u zbatuar dhe është në fuqi, dikton rrethin e subjekteve që gëzojnë statusin e magjistratit dhe

---

<sup>10</sup> Neni 164 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i titulluar “Dispozitat kalimtare për magjistratët e gjykatave dhe prokurorive të tjera”, parashikon: “1. Gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse: a) ...b) kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

ndaj të cilëve zbatohen dispozitat ligjore të ligjit “Për Statusin” dhe si rrjedhojë dhe të dispozitave që rregullojnë përgjegjësinë e tyre disiplinore.

30.9 Bazuar në vendimin e {...} lënë në fuqi nga {...} , rezulton se Z. {...}, nuk e ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, për shkak të dhënies ndaj tij, të masës disiplinore “*Shkarkim nga detyra*”, masë e cila ka shkaktuar mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, pra të statusit të tij si magjistrat.

30.10 Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se fakti që masa disiplinore “*Shkarkim nga detyra*”, e dhënë ndaj ish magjistratit {...} nuk është vendosur nga ky Këshill, sipas përcaktimeve të ligjit “Për Statusin”, nuk mund të çojë në mos ekzistencën e kësaj mase disiplinore dhe faktit që kjo masë ka sjellë si pasojë mbarimin e statusit të tij si magjistrat. Si e tillë kjo masë disiplinore, krijon të njëjtat pasoja si dhe masa disiplinore e “*Shkarkimit nga detyra*”, e parashikuar nga neni 111 i ligjit “Për Statusin”.

30.11 Një masë e tillë e dhënë sipas përcaktimeve të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pra mbi bazën e një ligji me natyrë kalimtare, nuk mund sanksionohet nga ligjvënësi si një mënyrë e mbarimit të statusit, në dispozitat e nenit 64 të ligjit “Për Statusin”, por vetëm në dispozitat kalimtare të tij. Konkretisht, është neni 164 të këtij ligji, i cili vendos një urë lidhëse midis dy ligjeve, duke zgjeruar interpretimin e shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 64, dhe duke sanksionuar se statusi i magjistratit mbaron edhe në rastet kur ai shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore sipas ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **V. KONKLUSIONE**

31. Sa më lart, duke vlerësuar se ndaj z. {...}, është marrë masa disiplinore e “*shkarkimit nga detyra*”, sipas nenit 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 58, pika 1, dhe 61, të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, fakt i cili përbën shkak për ndërprerjen e menjëhershme të ushtrimit të detyrës dhe mos gëzimin nga ana e tij të statusit të magjistratit, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në përfundimin se statusi i tij si magjistrat ka mbaruar për shkak të shkarkimit nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të nenit 64, pika 1, shkronja “ç” dhe nenit 164 i ligjit “Për Statusin”.

32. Në vijim, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se jemi para rastit mbylljes së procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore për ish magjistratin {...}, si pasojë, procedimi disiplinor i filluar në ngarkim të tij nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk duhet të fillonte dhe si i tillë ky procedim nuk duhet të vazhdojë.

33. Për sa i përket të drejtës së subjekteve për të ushtruar të drejtën e ankimit, referuar parashikimeve të nenit 100 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” të ndryshuar, përcaktohet se ndaj aktit administrativ individual mund të bëhet ankim në Gjykatën {...}, në rastet kur ato nuk vendosin masa disiplinore mbi gjyqtarët. Këto të fundit ankimohen vetëm në {...}, në zbatim të nenit 179, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në vijim, të ushtrimit të kësaj të drejte subjektet sipas këtij vendimi kanë të drejtën për të ankimuar vendimin në Gjykatën {...}, brenda 15 ditëve, afat i cili fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a pika 1, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 139 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në nenin 31, pika 1 të Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”,

### **V E N D O S I:**

1. Mbyllet e procedimit disiplinor të filluar me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndaj ish magjistratit {...}, pa zhvilluar seancë dëgjimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën {...} brenda 15 ditëve, afat i cili fillon nga e dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

**Kryetare**  
**NAUREDA LLAGAMI**

**Zëvendëskryetar**  
**MAKSIM QOKU**

**Anëtar**  
**MEDI BICI**

**Anëtar**  
**ILIR TOSKA**

**Anëtare**  
**BRIKENA UKPERAJ**

**Anëtare**  
**FATMIRA LULI**

**Anëtare**  
**BRUNILDA KADI**

**Anëtare**  
**MARÇELA SHEHU**

**Anëtar**  
**ERJON MUHARREMAJ**

**Anëtar**  
**ALBAN TORO**

**Anëtar**  
**DRITAN HALLUNAJ**